



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 08.06.2023

Procesverbali i dëgjimeve Buxhetore për kornizën afatmesme buxhetore 2024 – 2026 me qytetarët e Shalës

Vendi i takimit:	Shkolla fillore “Ibrahim Banushi”, Shalë
Ora:	20:30
Përfaqësuesit institucional:	Latif Ramadan, Safete Amerllahu, Visar Kozhani
Pjesëmarrësit	Qytetarët e Shalës
Përgatitja e procesverbalit	Grupi punues për hartimin e planifikimit të projekt buxhetit 2024-2026
Numri i pjesëmarrësve:	19
Burra:	17
Gra:	2

Prezantimi i Buxhetit:

Drejtori për Buxhet dhe Financa Latif Ramadani, ka bërë hapjen e takimi dhe ka prezantuar planifikimin e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024-2026.

Gjatë këtij takimi drejtori për Buxhet dhe Financa ka prezantuar planifikimin e buxhetit të Komunës së Lipjanit dhe ka pranuar të gjitha kërkesat që kanë dalur nga këto takime. Ai po ashtu ka inkurajuar qytetarët që të marrin pjesë sa më shumë në këto takime sepse kanë rëndësinë e veçantë dhe është mundësia më e mirë për përfshirjen e kërkesave të qytetarëve. Si dhe ka falënderuar për pjesëmarrjen në takimin e parë për kornizën afatmesme buxhetore 2024 – 2026 me theks të veçantë investimet kapitale dhe investimet tjera të cilat do ti bëjë komuna për gjatë viteve 2024 – 2026.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Pyetjet e qytetarëve:

Xhylë Hoti-Korpuzi – Unë si kryetare e fshatit së bashku me kryesin e fshatit i kemi mbajtur 18 mbledhje e që të gjitha kanë qenë me karakter të interesit qytetarë e nga kjo kanë dalë disa kërkesa bazike e të cilat i kam dorëzuar edhe në komunë andaj unë po i paraqes edhe këtu në këtë mbledhje, kërkoj së pari ujësjellësin, pastaj kanalizimet, disa puset, po ashtu të intervenohet edhe në rrymë sepse po kemi problem.

Bashkim Avdyli – Të asfaltohen disa rrugica, tjetra është një kanalizim që është blloku këtu te Baica kërkoj që aty të intervenohet sepse ka kundërmim të madh.

Izet Shala – Një kërkesë e kam të shkollës, shkolla është ndërtuar që 22 vite andaj kjo shkollë meriton investim duke filluar prej renovimit sepse po kemi problem me dritaret e me dyert andaj nëse ka mundësi të planifikohet renovimi i shkollës.